

**DEKLARATË E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I  
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-ut  
DEBATI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-un  
NJU JORK, 15 TETOR 2021**

z. kryetar,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Sigurimit,

Kam kënaqësinë që jam sot me ju për t'iu raportuar lidhur me zhvillimet kryesore në Kosovë që kanë ndodhur që nga takimi ynë i fundit në prill.

Pas përfundimit të periudhës zyrtare të raportimit, të cekur në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, kemi kaluar nëpër zhvillime, të cilat na përkujtojnë – përtej ngjarjeve të fundit në Kosovë – se mungesa e reflektimit politik dhe e komunikimit është shtytës e përshkallëzimit të tensioneve, posaçërisht në mjediset e brishta të sigurisë, të karakterizuara me mosbesim.

Në mëngjesin e 20 shtatorit, Prishtina ka nisur një operacion policor në Kosovën veriore me qëllim të zbatimit të masave të reja të vlefshmërisë së targave. Duke marrë parasysh diskutimet e ndjeshme dhe të kamotshme për lirinë e lëvizjes, të

realizuara gjatë viteve përmes dialogut të mbështetur nga BE-ja, do të ishte e natyrshme të pritët një komunikim i hershëm dhe i qartë me ata që preken. Megjithatë, komunikimi i autoriteteve ka qenë i pakët apo fare nuk ka ekzistuar. Bashkësisë ndërkombëtare në terren, duke përfshirë KFOR-in që ka përgjegjësinë për ruajtjen e një mjedisi të qetë dhe të sigurt, nuk i është dhënë njoftim paraprak.

Rrjedhimisht është krijuar një bllokadë pasi që protestuesit bllokuan trafikun në pikat kufitare veriore përgjatë kufirit administrativ. Njësitë speciale të Policisë së Kosovës, të armatosura me armatim të gjatë, erdhën në vendkalimet veriore me automjete të blinduara. Këto njësi njëherë kanë përdorë gazin lotsjellës dhe granatat zhurmuese të tymit për shpërndarjen e protestuesve. Gjatë disa ditëve pasuese, numrat e protestuesve dhe të njësive të policisë speciale u rritën. Më 26 shtator, një zjarr ende i pashpjeguar ka ndodhur në qendrën e regjistrimit në Zubin Potok, ndërsa në natën e 25 shtatorit është zbuluar një mjet shpërthyes i padetonuar në një zyrë tjetër publike në veri. Nga ana e saj, ushtria e Serbisë dërgoi në afërsi një togë si forcë reaguese, në veri të kufirit administrativ, dhe bëri disa fluturime ushtarake në të njëjtën zonë.

z. kryetar,

Zyrtarët ndërkombëtarë, siç jam unë, që kanë përvojë të gjatë në terren, vështirë që do të mund të befasoheshin nga ky reagimi i kësaj përpjekje të fuqishme të armatosur për të zbatuar ndryshim të politikave, duke marrë parasysh historikun e mosbesimit dhe ndjeshmërisë së marrëdhënieve mes komuniteteve në veri. Fakti që kjo përpjekje nuk është diskutuar përmes kanaleve të krijuara – pikësëpari, dialogu i mbështetur nga BE-ja për lirinë e lëvizjes – rezultoi në një përshkallëzim të pashmangshëm dhe potencialisht të rrezikshëm që zgjati dhjetë ditë. Falë ndërmjetësimit të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian, Borrell, të përkrahur edhe nga diplomacia e Shteteve të Bashkuara, është arritur marrëveshja për shtensionimin e situatës potencialisht të rrezikshme. Në këtë marrëveshje parashihej tërheqja e njësisve speciale të Policisë së Kosovës nga veriu dhe një rritje e pranisë së KFOR-it, me qëllim të krijimit të një ambienti të qetë dhe të sigurt. Me këtë marrëveshje është arritur një zgjidhje e përkohshme për vlefshmërinë e targave, ku diskutimet do të vazhdojnë gjatë gjashtë muajve vijues.

Ajo çka pamë në veri mund të quhet një episod i mavijosjes që shumë lehtë do të mund të shndërrohej në gjakderdhje të vërtetë. Jostabiliteti i situatës gjithashtu

mund të kuptohet edhe nga intervenimet e drejtpërdrejta personale me udhëheqësit e Prishtinës dhe Beogradit, në mes të tjerëve, të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg, dhe kryetares së Komisionit Evropian, von der Leyen. Duke monitoruar gjendjen nga afër, Misioni im gjithashtu ka luajtur rol në qetësimin e gjakrave në terren, duke shfrytëzuar eksperiencën tonë në veri me qëllim të inkurajimit të qetësimit dhe të zvogëlimit të gjasave të konfrontimit aksidental apo të pakontrolluar mes policisë speciale dhe qytetarëve. Gjithashtu kam ngritur zërin kundër veprimeve të njëanshme, duke thirrur për një lidhësi të përgjegjës dhe duke kërkuar hapa të menjëhershëm për zvogëlimin e tensioneve dhe vazhdim të dialogut politik.

Dhe, mu këtë të mërkurë të kaluar, njësitë speciale të Policisë së Kosovës prapë u dërguan në veri, si pjesë e asaj që përshkruhet si operacione kundër kontrabandës, të drejtuara në disa lokacione në Kosovë. Është diskutabile nëse KFOR-i është njoftuar si duhet paraprakisht për dërgimin e njësive speciale të policisë. Gjatë ditës, ky operacion provokoi protesta të tjera dhe konfrontime që rezultuan me një numër të konsiderueshëm lëndimesh në mesin e protestuesve, policisë dhe qytetarëve të papërfshirë, duke përfshirë në një rast lëndime me kërcënim për jetën, të shkaktuara nga të shtënat e policisë në rrethana që ende duhet të sqarohen. Popullata civile në veri të Mitrovicës raportoi lëndime në

shtëpitë e tyre nga gazi lotsjellës dhe granatat tymosëse e zhurmuese, të cilat i përdori policia gjatë disa orëve. Protestuesit gjuajtën me gurë, dhe sipas Policisë së Kosovës, disa të dyshuar përdorën armë zjarri për të angazhuar policinë. Më pas Përfaqësuesi i Lartë i BE-së Borrell, deklaroi se “veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara që rrezikojnë stabilitetin janë të papranueshme.....çështjet duhet adresuar përmes Dialogut të përkrahur nga BE-ja.” Të mbash llogari për kontekstin dhe të jeshë përgjegjës për mendimin paraprak janë esenciale për të shmangur pasoja të pamenduara dhe përshkallëzim strategjikisht të rrezikshëm. Këto veprime të fundit thelluan mosbesimin tek popullata serbe në veri dhe çuan në reagime të forta në Beograd, duke e bërë kështu imperativ edhe më të madh ripërkushtimin e përgjegjshëm ndaj dialogut.

z. kryetar,

Unë kam biseduar në hollësi për këto ngjarje të 20-30 shtatorit dhe për çështje të tjera si me kryeministrin Kurti, ashtu edhe me presidentin Vuçiq. Gjithashtu kam qenë i përfshirë në bisedime me palët diplomatike të përfshira, posaçërisht me ato të Shteteve të Bashkuara, të Federatës Ruse dhe të Kinës, si dhe me komandantin e KFOR-it dhe zyrtarët e BE-së. Këtu mund të them se ekzistojnë disa mësimet të rëndësishme – ose më mirë t’i quaj përkujtes – që dalin në shesh

kur kemi të bëjmë me marrëdhëniet mes Prishtinës dhe Beogradit, stabilitetit regional dhe domosdoshmërisë së procesit të dialogut. Dialogu mund dhe duhet të jetë mekanizëm për shmangien e rreziqeve që shpesh nuk janë shumë të dukshme, por janë aq reale sa ka qenë edhe gjatë këtyre njëzet viteve të shkuara. Historia në regjion në mënyrë tragjike dhe të përsëritur ka treguar që incidentet në dukje të vogla, keqkuptimi i qëllimeve dhe gabimet mund të nxisin përshkallëzim jostabil të sigurisë që rrezikojnë jetën dhe nga të cilat askush nuk përfiton.

z. kryetar,

Akterët ndërkombëtarë, duke përfshirë ne dhe përfaqësuesit në këtë Këshill, mirëpritën takimin e fundit midis presidentit Vuçiq dhe kryeministrit Kurti më 6 tetor gjatë Samitit BE-Ballkani Perëndimor, në prani të presidentit francez Makron dhe kancelares gjermane Merkel. Sidoqoftë, do të ishte e parakohshme dhe tepër optimiste të themi se mund të shohim një rifillim të angazhimit real ndaj dialogut, i cili mbetet forumi i vetëm në të cilin diskutimet e përgjegjshme dhe të orientuara drejt rezultateve mund të vazhdojnë.

Unë e theksova rëndësinë e vazhdimësisë në dialog me presidentin Vuçiq dhe kryeministrin Kurti gjatë bisedimeve me ta. Kjo është një sfidë e madhe edhe për

institucionet e BE -së, të cilat janë të ngarkuara ta udhëheqin këtë proces në mënyrë kuptimplote. Ajo që vura re dhe dëgjova në takimet e mia me përfaqësuesit e fuqive kryesore ndërkombëtare të përfaqësuara në këtë Këshill, është se pavarësisht dallimeve të tjera, ata qartë e kuptojnë se nuk ka alternativë të arsyeshme për angazhimin e vazhdueshëm në dialog. Ky është një minimum për të ndihmuar në shmangien e potencialit regresiv të shfaqur këto javë të fundit. Po ashtu, është e rëndësishme të mbështeten të gjitha nismat që mund të ndihmojnë në promovimin e marrëdhënieve të përgjegjshme midis të gjithë fqinjëve në Ballkanin Perëndimor.

Nga pikëpamja ime, besimi vazhdon të jetë i pamjaftueshëm - besimi në negociatat me mirëbesim, besimi midis përfaqësuesve dhe zonave të tyre zgjedhore dhe besimi në institucionet që janë krijuar për të ofruar të dyja.

Duke vëzhguar ciklet e shumta të këtij dialogu për më shumë se gjashtë vite, bindja ime personale është akoma e fuqishme se, nëse shumica dërrmuese e njerëzve nga komunitete të ndryshme, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë, nuk e ndiejnë veten të jenë pjesë ose të jenë të përfshirë në proceset e diskutimit dhe negociimit politik, nëse nuk ka mobilizim të shoqërisë, dhe nëse ata nuk janë paktëntë vetëdijshëm për atë që po diskutohet, atëherë të gjitha përpjekjet për të ndryshuar marrëdhëniet dhe për të zgjidhur tensionet afatgjata, janë të destinuara të mbeten të pakapshme. Një marrëveshje e mbështetur në letër është një qëllim jetik. *Por të keshë një letër në dorë nuk është e njëjtë sikur të keshë një zgjidhje në dorë.* Ata që mund të ushtrojnë më shumë ndikim te palët negociuese për të pasur sukses, janë kryesisht të lodhur nga argumentet vështirë të qëndrueshme dhe sloganet nacionaliste politike. Kjo është e vërtetë në Kosovë, është e vërtetë në Serbi dhe është e vërtetë në të gjithë rajonin.

z. kryetar,

Derisa Kosova po u afrohet edhe një herë zgjedhjeje lokale brenda dy ditësh, fokusi në nivelin qendror dhe komunal tani duhet të orientohet në realizimin e pritjeve të larta të njerëzve për ndryshim. Pse pjesëmarrja ishte kaq e lartë në



zgjedhjet e kaluara të përgjithshme? Në fakt, atë që populli kërkonte ishte një qeveri më aktive dhe më të përgjegjshme, e cila qartazi do të përmbushte agjendën e reformave të premtuara gjatë periudhës së fushatës. Përveç kësaj, votuesit duan qartë që institucionet publike të punojnë në favor të mirëqenies së njerëzve, për dallim nga e kaluara. Ata duan barazi më të madhe në mundësitë ekonomike dhe sociale, drejtësi, llogaridhënie dhe mbështetje të besueshme në sundimin e ligjit.

Prandaj, kryeministri Kurti, i cili të paktën në dy raste ka ndarë me mua prioritetet kryesore të qeverisë së tij, më siguroi fokusimin e tij në këtë agjendë reformash, duke e quajtur atë prioritet parësor të tij. Unë sot publikisht i bëj thirrje qeverisë, siç kam bërë privatisht, të përqëndrohet në rindërtimin e lidhjeve të besimit të rrënuara kaq gjatë midis të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe lidhshimit politik. Rindërtimi i besimit kërkon një qasje të sigurtë ndaj procesit të dialogut Beograd-Prishtinë, si dhe krijimin e një atmosfere inkurajuese në mesin e komuniteteve të ndryshme brenda Kosovës. Ballafaqimi me maturi dhe përgjegjësi me të kaluarën është një parakusht për stabilitet, i cili përfshin shmangien e instrumentalizimit të temave përçarëse etno-nacionaliste për përfitime politike.

Kam pas shumë biseda me liderët rajonale gjatë vitit të kaluar, përfshirë presidentin Vuçiq dhe kryeministrin e Shqipërisë Rama, dhe dua të theksoj se qasjet praktike rajonale kanë filluar të evoluojnë, duke shfrytëzuar interesin e përbashkët në rritjen e prosperitetit si një nxitës për të bërë një rajon më stabil. Ashtu si Procesi i Berlinit, mbi të cilin pjesërisht u modelua, Nisma për Ballkanin e Hapur, e promovuar nga presidenti Vuçiq, kryeministri Rama dhe kryeministri Zaev i Maqedonisë së Veriut, është sipas mendimit tim një hap premtues pikërisht në këtë drejtim, përkundër dallimeve për detajet dhe formën e saj.

z. kryetar,

Pandemia COVID-19 vazhdon të paraqesë një sfidë të paprecedent për Kosovën dhe për rajonin. Kufizimi i përhapjes së saj dhe zbutja e pasojave socio-ekonomike, është një çështje tjetër që kërkon bashkëpunim përtej kufijve, kufijve administrativ dhe përkatësisë etnike.

Kombet e Bashkuara, përmes donacioneve COVAX, kanë ndihmuar programin e vaksinimit të Kosovës, dhe UNMIK-u dhe EKBK-ja kanë punuar ngushtë me

autoritetet për të inkurajuar dhe promovuar pranimin e vaksinimeve dhe masave parandaluese. Unë jam krenar që UNMIK-u dhe Ekipi i KB-së në Kosovë kanë kontribuar në rritjen e kapacitetit të testimit dhe vaksinimit të COVID-19 në Kosovë, kanë ofruar ndihmë humanitare dhe pajisje për më të cenuarit, dhe janë fokusuar gjithashtu në monitorimin objektiv të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në lidhje me pandeminë. Me mbështetje të fortë nga Selia, ne përfundam me sukses një fushatë vaksinimi për të gjithë personelin e Kombeve të Bashkuara dhe vartësit e tyre, ndërkombëtarë dhe vendorë, jo vetëm UNMIK-u, por edhe të gjitha entitetet e tjera të KB -së në terren.

z. kryetar,

Në përputhje me mandatin tonë, Misioni vazhdon të angazhohet gjerësisht në terren, në sektorë të shumtë dhe fusha të veprimit, të vendosur nga një agjendë kushtuar promovimit dhe mbështetjes së ndërtimit të besimit në mesin e komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Unë kam folur tashmë për besimin si një preokupim kryesor i kohës dhe vizionit tim për Misionin tonë, një strategji të cilën ne e kemi krijuar dhe përmirësuar përmes përvojës. Një punë e tillë është e domosdoshme dhe duhet të vazhdojë, për arsye që theksova më herët. Ne kemi përdorin instrumentin e rëndësishëm të fondeve tona programore, për të krijuar

ambientin dhe për të filluar realizimin e pothuajse të gjitha objektivave të parashtruara në Forumin e Ndërtimit të Besimit të KB –së, të cilin unë e kam drejtuar në vitin 2018, përmes përpjekjeve të kombinuara të UNMIK-ut, EKBK-së dhe shumë partnerëve ndërkombëtarë që punojnë krah për krah me anëtarët e komuniteteve të ndryshme që besojnë në një të ardhme paqësore së bashku. Nga puna jonë në promovimin e agjendave për gratë dhe rininë, paqen dhe sigurinë, për mbështetjen e arsimit shumëgjuhësor, për financimin dhe bashkësponsorizimin e debatit në televizion dhe platformat e reja të medias, për ofrimin e ndihmës juridike dhe edukimit për qasje në drejtësi, ne kemi ndihmuar në krijimin e modelit të qasjes që në qendër ka popullin dhe angazhimin në nivel shoqëror, të artikuluar nga programi i reformës i Sekretarit të Përgjithshëm dhe agjenda e përbashkët. Ky është roli katalitik të cilit Misioni ynë i mbetet i përkushtuar, duke u angazhuar me zërat për ndryshim dhe duke i fuqizuar ata, ndërsa zbatojmë kreativitetin tonë, të kuptuarit dhe analizën tonë të rrethanave reale për të promovuar përfitime afatgjata dhe të qëndrueshme për të gjithë. Sipas mendimit tim, një punë e tillë është themeli i një marrëveshjeje të qëndrueshme, pa të cilën ciklet vicioze të mosbesimit publik dhe përdorimi i retorikës përçarëse për përfitime politike afatshkurtra, thjesht do të përsëriten. Ngjarjet e javëve të kaluara, me tendencën për të minuar përparimin e

qëndrueshëm por të brishtë të arritur në rindërtimin e besimit mes komuniteteve, janë shqetësim i thellë për mua dhe duhet të jenë një paralajmërim për të gjithë anëtarët e këtij Këshilli.

z. kryetar,

Falënderoj anëtarët e Këshillit shumë sinqerisht për vëmendjen e tyre dhe për mbështetjen e vazhdueshme gjatë gjithë këtyre viteve për mua dhe UNMIK-un.

Faleminderit.